



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive  
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

# Analizë Politikash

Zbatimi i dispozitave ligjore për deklarimin e pasurisë nga zyrtarët e lartë të zgjedhur drejtpërdrejt në nivel qendror

*Korrik 2011*



National Endowment *for* Democracy  
*Supporting freedom around the world*

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga National Endowment for Democracy. Qëndrimet në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e NED.

### Hyrje

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë, në mars 2010, Agjencia Kundër Korrupsionit ka organizuar deklarin e pasurisë për zyrtarët e lartë publikë dhe gjithashtu ka publikuar në ueb-faqen e saj të gjitha deklarinimet e pasurisë, por edhe vendimet e gjykatave ndaj atyre zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë. Informatat e publikuara mbi deklarinin e pasurisë dhe raportet e këtij institucioni tregojnë për një rritje të konsiderueshme të shkallës së zbatimit të këtij ligji, dhe shkalla e deklarimit të pasurive arrin mbi 90%. Sa i përket deklarimit të pasurisë, në të janë përfshirë zyrtarët e lartë të të gjitha kategorive të institucioneve dhe organeve publike: Presidencës, Kuvendit, Qeverisë, Gjykatave, Institucioneve të tjera të pavarura, Komunave dhe ndërmarrjeve publike. Sa i përket Kuvendit, edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u ka kërkuar deklarinin e pasurisë të gjithë kandidatëve për deputetë për zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010.

Megjithatë, përtej anës formale dhe strikte legale të deklarimit dhe publikimit të pasurisë si akt simbolik i llogaridhënies dhe transparencës së të zgjedhurve dhe zyrtarëve publikë ndaj zgjedhësve dhe taksapaguesve, korniza ligjore në fuqi gjithashtu kërkon monitorim dhe kontroll sistematik të të dhënave mbi pasuritë e të zgjedhurve dhe zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë nga ana e publikut. Përmes kësaj synohet parandalimi i vazhdueshëm dhe sistematik i korrupsionit, gjë që, nga ana tjetër, kërkon fokus të veçantë në aspektet cilësore të deklarimit të pasurisë. Cilësia dhe standardet adekuate për deklarinin dhe kontrollin e pasurisë kanë rëndësi kyçe në mënyrë që ky mekanizëm i zbatimit të ligjit dhe politikave kundër korrupsionit t'i shërbejë efektivisht qëllimit - parandalimit të korrupsionit.

Kjo analizë politikash fokusohet pikërisht në anën cilësore të deklarimit të pasurisë. Kjo bëhet duke u fokusuar në një grupi zyrtarësh të lartë të zgjedhur drejtpërdrejt, përkatësisht duke i krahasuar deklarinat e pasurisë së tyre Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (të dyja të bëra në vitin 2010). Me këtë synohet që duke i identifikuar të dhënat potencialisht të gabuara dhe mospërputhjet e mundshme, të jepet një pasqyrë se me çfarë sfidash dhe problemesh mund të përballlet procesi i deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë nga aspekti teknik, në mënyrë që pastaj të mund të përmirësohet dhe të avancohet zbatimi i obligimit kushtetues dhe ligjor të zyrtarëve të lartë për të deklaruar pasurinë e tyre.

### Dispozitat ligjore për deklarinin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Ligji në fuqi për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë është miratuar nga Kuvendi në shkurt 2010. Sa i përket qëllimit të tij, "Ky ligj përcakton detyrimet e zyrtarëve të lartë publikë për ta deklaruar pasurinë, dhuratat dhe prejardhjen e tyre."<sup>1</sup> Sa i përket fushëveprimit, ky ligj synon të rregullojë kontrollin publik të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, të hyrave, përfitimeve të tjera materiale dhe detyrimeve financiare të tyre, anëtarëve të familjes së tyre dhe personave të lidhur me ta, dhe gjithashtu përcakton sanksionet përkatëse.<sup>2</sup> Në anën tjetër, Ligji për

---

<sup>1</sup> Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë, Neni 1, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-151-alb.pdf>

<sup>2</sup> Poaty, Neni 2

Agjencinë Kundër Korrupsionit përcakton se kompetencat e këtij institucioni përfshijnë edhe atë për mbikëqyrjen e pasurive të zyrtarëve të lartë publikë dhe personave të tjerë të lidhur me ta dhe ndërmarrjen e masave të parapara me ligj.<sup>3</sup> Kjo tregon se dispozitat e ndryshme ligjore nuk i rregullojnë në mënyrë uniforme çështjet e deklarimit, prejardhjes dhe kontrollit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

Ndonëse Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit specifikojnë se fushëveprimi i tyre, mes tjerash, është kontrolli dhe mbikëqyrja e pasurive të zyrtarëve të lartë publikë, pjesa tjetër e Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe mënyra se si është zbatuar ky ligj deri më tani tregon se bëhet fjalë për monitorimin e të dhënave mbi pasuritë e zyrtarëve të lartë publikë. Kjo realizohet përmes obligimit ligjor të tyre që t'i dërgojnë Agjencisë Kundër Korrupsionit të dhënat mbi pasuritë e tyre e të anëtarëve të familjes së tyre të ngushtë, si dhe duke e obliguar Agjencinë që t'i publikojë këto të dhëna rregullisht. Në këtë mënyrë synohet parandalimi i korrupsionit përmes sigurimit të transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut mbi pasuritë e zyrtarëve të lartë publikë.

Sa i përket kontrollit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, ky ligj nuk përmban ndonjë dispozitë që përcakton procedurat dhe mekanizmat kontrollues, përveç Nenit 14, i cili përcakton detyrimin e Agjencisë Kundër Korrupsionit për verifikimin e saktësisë së të dhënave të deklaruara në formular. Më tej, edhe sa i përket kësaj, ky ligj është deri diku i vagullt pasi që nuk qartëson se si duhet të kryet ky kontroll dhe as vendos obligime specifike për persona të caktuar fizikë e juridikë për të bashkëpunuar me Agjencinë si institucion kryesor zbatues për të mundësuar verifikimin e këtyre lloj të dhënash në mënyrë efektive.

Për të mundësuar kontrollin dhe mbikëqyrjen rigoroze të pasurive të zyrtarëve të lartë, Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë do të duhej të përmbante dispozita ligjore dhe të vendoste mekanizma për të siguruar këtë lloj kontrolli dhe mbikëqyrje, përfshirë dispozita mbi obligimet dhe përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse për të ushtruar këtë lloj kontrolli dhe mbikëqyrje në mënyrë të efektshme dhe të pavarur. Megjithatë, ky ligj nuk përmban ndonjë dispozitë të këtij lloji, e as ndonjë dispozitë që do të specifikonte se çfarë masash, dhe nga cili institucion, duhet të merren për të siguruar transparencën e prejardhjes së pasurisë në rast të mospërputhjes në mes të pasurisë së deklaruar nga secili zyrtar i lartë dhe të burimit të të ardhurave.

Në këtë kontekst, do të duhej të ekzistonin dispozita dhe procedura 'alarmimi' përmes të cilave Agjencia Kundër Korrupsionit, si institucion që mbledh dhe përditëson informatat mbi deklarimin e pasurisë së secilit zyrtar të lartë publik, do të evidentonte rastet e mospërputhjeve të tilla. Pas kësaj, Agjencia do të duhej të adresonte këto mospërputhje me vetë zyrtarët dhe mbikëqyrësit e tyre, në mënyrë që pastaj secili institucion të mund të qartësonte më tej të gjitha burimet e pasurisë së zyrtarëve të tij. Kjo do të duhej të bëhej në përputhje të plotë me dispozitat ligjore për mbrojtjen e privatësisë së secilit zyrtar, duke synuar ekskluzivisht zbulimin e burimeve potencialisht të paligjshme të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. Kjo gjithashtu do të kërkonte ekzistimin e procedurave paralajmëruese dhe sanksioneve administrative ndaj zyrtarëve të lartë publikë të cilët do të refuzonin të ofronin informatat e kërkuara.

---

<sup>3</sup> Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Neni 2, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009-159-alb.pdf>

Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë gjithashtu përcakton kategoritë e zyrtarëve të lartë publikë dhe të pjesëtarëve të familjes së tyre që obligohen të deklarojnë pasuritë<sup>4</sup>, si dhe kategoritë e pasurive të cilat ata janë të detyruar t'i deklarojnë, llojet e deklarimit dhe shpeshtësinë e deklarimit të tyre<sup>5</sup>. Më tej, ai vendos edhe dispozitat ndëshkimore të kategorisë së kundërvajtjeve dhe procedurat e ekzekutimit të tyre<sup>6</sup>.

### Zbatimi i dispozitave ligjore për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë përcakton katër kategori të deklarimit të pasurisë: deklarimin e rregullt vjetor, deklarimi me marrjen e detyrës së zyrtarit të lartë publik, deklarimin sipas kërkesës së Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe deklarimin pas largimit nga funksioni.<sup>7</sup> Sa u përket politikave për zbatimin e këtij obligimi ligjor, Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit 2009 - 2011 përmban një objektiv strategjik (1.3), i cili kërkon, mes tjerash, ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe zbatimin efikas të legjislacionit përkatës për të siguruar transparencën në vendimmarrje dhe të pasurive të personave që kanë detyra publike. Ky objektiv strategjik përmban vetëm një objektiv specifik, që mbulon edhe çështjen e deklarimit dhe kontrollit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, i cili objektiv parasheh ngritjen e kapaciteteve të qeverisë për zbatimin e legjislacionit relevant. Më tej, për arritjen e këtij objektiv janë paraparë dy aktivitete: (1) hartimi dhe miratimi nga ana e Qeverisë dhe Kuvendit i një plani i cili të përcaktojë objektivat, modalitetin dhe afatet për zbatimin e legjislacionit relevant, dhe (2) ofrimi i trajnimeve Qeverisë për zbatimin e këtij legjislacioni. Institucionet përgjegjëse për kryerjen e këtyre veprimeve janë Zyra e Kryeministrit dhe Kuvendi, kurse kryerja e tyre është paraparë deri në prill 2011.<sup>8</sup>

Përparimi në zbatimin e kornizës ligjore dhe të politikave kundër korrupsionit monitorohet nga Agjencia Kundër Korrupsionit përmes raportit vjetor të saj, i cili publikohet rregullisht, pas diskutimit dhe miratimit në Kuvend. Kur jemi të monitorimi i implementimit të aktiviteteve të sipërpërmendura rreth deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, në raportin e parë vjetor pas miratimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2009 - 2011 thuhet se është mbajtur një trajnim me pikat e kontaktit nëpër institucionet e Kosovës mbi formularin e deklarimit të pasurisë, por ai raport nuk përmban asnjë informatë në lidhje me atë se deri ku është arritur në hartimin e planit të sipërpërmendur nga ana e Qeverisë.<sup>9</sup>

Megjithatë, ky raport përmban të dhëna të hollësishme mbi numrin e zyrtarëve të lartë të obliguar për të deklaruar pasurinë, numrin e atyre që e kanë kryer këtë obligim gjatë periudhës raportuese e të atyre që nuk e kanë bërë këtë, si dhe numrin e zyrtarëve ndaj të cilëve Agjencia Kundër Korrupsionit ka kërkuar shqiptimin e sanksioneve administrative. Sipas të njëjtit raport, nga gjithsej 800 zyrtarë të lartë publikë të obliguar për të deklaruar

<sup>4</sup> Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë, Neni 3, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-151-alb.pdf>

<sup>5</sup> Poaty, Nenet 4 – 9

<sup>6</sup> Poaty, Nenet 16 – 19

<sup>7</sup> Poaty, Nenet 5 – 9

<sup>8</sup> Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit 2009 – 2011 (e rishikuar), fq. 11 – 12, [http://www.akk-ks.org/repository/docs/Vendimi\\_dhe\\_Plani\\_i\\_Veprimit\\_kunder\\_Korrupsionit\\_i\\_rishikuar.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/Vendimi_dhe_Plani_i_Veprimit_kunder_Korrupsionit_i_rishikuar.pdf)

<sup>9</sup> Raporti Vjetor i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit (1 janar – 31 dhjetor 2009), fq. 24, [http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti\\_vjetor%20i\\_Agjencise\\_kunderkorrupsionit\\_1\\_Janar\\_31\\_Dhjetor\\_2010.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti_vjetor%20i_Agjencise_kunderkorrupsionit_1_Janar_31_Dhjetor_2010.pdf)

pasurinë, 619 prej tyre e kanë deklaruar pasurinë, kurse 173 prej tyre nuk e kanë bërë këtë, gjë që paraqet një shkallë prej 78.1% të zbatimit.<sup>10</sup> Sa i përket vitit 2010, brenda afatit të parë të deklarimit (31 mars 2010) shkalla e zbatimit është rritur për 9.97% (rritje nga 78.1% në 88.07%). Shprehur në shifra absolute, nga 1560 zyrtarë të lartë të obliguar për të deklaruar pasurinë, 1374 prej tyre e kanë bërë këtë e 186 prej tyre jo, kurse deri në qershor kanë mbetur vetëm 69 prej tyre që nuk e kanë deklaruar pasurinë.<sup>11</sup> Brenda afatit përfundimtar për deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë, shkalla e zbatimit raportohet të jetë rritur për 7.63% (nga 88.07% në 95.7%).<sup>12</sup> Sa i përket bashkëpunimit ndër-institucional në deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, në raportin e vitit 2009 raportohet refuzimi nga ana e dy institucioneve ekzekutive për të bashkëpunuar me Agjencinë Kundër Korrupsionit në ofrimin e informatave të kërkuara<sup>13</sup>, kurse në atë të vitit 2010 nuk është raportuar ndonjë pengesë e kësaj natyre.<sup>14</sup>

### Deklarimi i pasurisë nga deputetët e Kuvendit të Kosovës Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë Agjencisë Kundër Korrupsionit bëhet përmes *Formularit për Deklarimin e Prejardhjes dhe Gjendjes së Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë*, i cili është zhvilluar dhe u shpërndahet rregullisht zyrtarëve të lartë nga Agjencia Kundër Korrupsionit. Sa u përket zyrtarëve të zgjedhur drejtpërdrejt, edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u kërkon atyre deklarimin e pasurisë, pas kandidimit të tyre në listën e kandidatëve të subjektit politik përkatës, gjë që kryhet përmes *Formularit të Publikimit Financiar të Kandidatit*. Sa i përket strukturës, formulari i KQZ-së është më adekuat se ai i AKK-së për zbulimin e prejardhjes së pasurisë, pasi që është më gjithëpërfshirës sa i përket kategorive të pasurive që kërkohet të deklarohen.

Për qëllim të kësaj analize janë përzgjedhur 27 zyrtarë të lartë shtetërorë. të cilët janë zgjedhur deputetë të legjislaturës aktuale të Kuvendit të Republikës së Kosovës (bazuar në renditjen e tyre në listën e kandidatëve të subjekteve të tyre politike). Ata e kanë deklaruar pasurinë sipas kërkesës së Agjencisë Kundër Korrupsionit deri më 31 mars 2010 (si pjesë e legjislaturës së kaluar të Kuvendit) dhe sipas kërkesës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në nëntor 2010 (pra rreth 7 muaj më vonë). Numri i zyrtarëve të përzgjedhur nga secila parti politike pasqyron përafërsisht numrin e deputetëve të secilës prej tyre që zënë vende në Kuvend, përkatësisht 12 nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), 9 nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), 3 nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)<sup>15</sup> dhe 4 nga Aleanca Kosova e Re (AKR). Në vijim krahasohen në hollësi të dhënat e deklaruara të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve<sup>16</sup> nga ana e zyrtarëve të lartë të zgjedhur

<sup>10</sup> Poaty, fq. 25 – 28

<sup>11</sup> Agjencia Kundër Korrupsionit – Mbikëqyrja e pasurive, <http://www.akk-ks.org/?cid=1,13,29>

<sup>12</sup> Raporti Vjetor i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit (1 janar – 31 dhjetor 2010), fq. 23 – 24, [http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti\\_Vjetor\\_2010\\_janar\\_dhjetor.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_2010_janar_dhjetor.pdf)

<sup>13</sup> Raporti Vjetor i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit (1 janar – 31 dhjetor 2009), fq. 29, [http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti\\_vjetor%20i\\_Agjencise\\_kunderkorrupsionit\\_1\\_Janar\\_31\\_Dhjetor\\_2010.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti_vjetor%20i_Agjencise_kunderkorrupsionit_1_Janar_31_Dhjetor_2010.pdf)

<sup>14</sup> Raporti Vjetor i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit (1 janar – 31 dhjetor 2010), fq. 30, [http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti\\_Vjetor\\_2010\\_janar\\_dhjetor.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_2010_janar_dhjetor.pdf)

<sup>15</sup> Duhet vënë re se numri i deputetëve të përzgjedhur nga AAK nuk është proporcional me numrin e gjithëmbarshtëm të vendeve të këtij subjekti në Kuvend, por ky kufizim është imponuar për faktin se vetëm 3 deputetë të këtij subjekti politik i kanë deklaruar pasurinë AKK-së, si pjesë e legjislaturës së kaluar, dhe KQZ-së, para zgjedhjeve për legjislaturën aktuale.

<sup>16</sup> Agjencia Kundër Korrupsionit: Deklarimi i pasurisë – Kuvendi i Republikës së Kosovës (Deputetët e Kuvendit), <http://www.akk-ks.org/?cid=1,1010>

*Formulari i Publikimit Financiar të Kandidatit – Partia Demokratike e Kosovës, Formulari i Publikimit Financiar të Kandidatit – Lidhja Demokratike e Kosovës, Formulari i Publikimit Financiar të Kandidatit – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Formulari i Publikimit Financiar të Kandidatit – Aleanca Kosova e Re, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhjetor 2010, Prishtinë*

drejtpërdrejt, të ndarë sipas përkatësisë partiake. Marrë parasysh metodologjinë e analizës, e cila ka kërkuar përzgjedhjen e zyrtarëve që u kanë deklaruar pasurinë të dyja këtyre institucioneve, nga zyrtarët e lartë të përzgjedhur ka edhe të tillë që aktualisht nuk e ushtrojnë detyrën e deputetit (për shkak të emërimit në pozita ekzekutive ose të tjera).

### Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

Në deklarin e pasurisë nga deputeti **Jakup Krasniqi** (pozita aktuale: Kryetar i Kuvendit) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në kategoritë në vijim: vlerën e patundshmërive (e njëjta sasi e pasurisë), para të gatshme, para të gatshme të mbajtura në institucione financiare dhe të hyra vjetore të tatueshme.<sup>17</sup> Në deklarin e pasurisë nga deputeti **Fatmir Limaj** (pozita aktuale: deputet) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në kategorinë e të hyrave vjetore të tatueshme.<sup>18</sup> Në deklarin e pasurisë nga deputetja **Vlora Çitaku** (pozita aktuale: ministre) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në kategorinë e pasurisë së paluajtshme (prejardhjes së saj) dhe në ata të të hyrave vjetore, kurse nuk është deklaruar asnjë pasuri tjetër familjare.<sup>19</sup>

Në deklarin e pasurisë nga deputeti **Hajredin Kuçi** (pozita aktuale: zëvendëskryeministër dhe ministër) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, para të gatshme, të hyra vjetore të tatueshme dhe detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë.<sup>20</sup> Në deklarin e pasurisë nga deputeti **Enver Hoxhaj** (pozita aktuale: ministër) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në kategorinë e parave të gatshme dhe atë të të hyrave vjetore të tatueshme.<sup>21</sup> Në deklarin e pasurisë nga ana e tij KQZ-së ky deputet nuk e ka bërë të qartë nëse është pasuri e tija personale apo e anëtarëve të familjes, kurse AKK-së i ka deklaruar pasurinë në pronësi të një anëtari të familjes. Në deklarin e pasurisë nga deputeti **Xhavit Haliti** (pozita aktuale: deputet) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: prona të patundshme, pasuri të luajtshme, para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, të hyra të përgjithshme vjetore nga pasuria dhe biznesi, dhe aksione dhe letra me vlerë. Ky deputet nuk ka deklaruar asnjë pasuri tjetër të anëtarëve të familjes.<sup>22</sup>

Në deklarin e pasurisë nga deputetja **Edita Tahiri** (pozita aktuale: zv.-kryeministre) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, të hyra vjetore të

<sup>17</sup> Pasuri të patundshme: €600,000 (AKK), €60,000 (KQZ); para të gatshme €100,000 (AKK), €115,000 (KQZ); para të gatshme të mbajtura në institucione financiare (nga anëtarët e familjes): asnjë (AKK), €21,000 (KQZ); të hyrat/pagat vjetore: €32,400 (AKK), €40,500 (KQZ).

<sup>18</sup> Të hyra/paga vjetore: €2,014 (AKK), €16,563 (KQZ).

<sup>19</sup> Pasuria e paluajtshme: familjare (AKK), e kandidatit (KQZ); të hyra/paga vjetore: €1,983 (AKK), €23,796 (KQZ).

<sup>20</sup> Para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: €16,000 (AKK), €15,000 (KQZ); para të gatshme: asnjë (AKK), €6,000 (KQZ); të hyrat/pagat vjetore: gjithsej €2,283 në muaj (€2,283 x 12 = €27,396; personale) dhe €420 në muaj (€420 x 12 = €5,040; anëtar i familjes) (AKK), €33,000 (KQZ); detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë: gjithsej €49,900 (AKK), €15,000 (KQZ, kredi).

<sup>21</sup> Para të gatshme, përkatësisht para të gatshme të mbajtura në bankë: €37,825 (AKK), €37,000 (KQZ); të hyra/paga vjetore: €38,652 (AKK), €20,669 (KQZ).

<sup>22</sup> Pasuria e paluajtshme: AKK-së i është deklaruar një pronë familjare me vlerë €120,000, kurse KQZ-së një pronë e kandidatit me vlerë €120,000 dhe tri prona familjare me vlerë të gjithëmbarshme prej €1,000,000; pasuri të luajtshme: €7,000 pasuri personale (AKK), €47,000 pasuri (€15,000 personale dhe €32,000 personale dhe të një anëtari të familjes); para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: €120,000 (AKK), €206,110 (KQZ); të hyra të përgjithshme nga biznesi: asnjë (AKK), €20,000 – ‘donacion nga familja’ (AKK); aksione dhe letra me vlerë: asnjë (AKK), €6,250 – aksione në një biznes (KQZ).



tatueshme dhe detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë.<sup>23</sup> Në deklarin e pasurisë nga deputetja **Adem Grabovci** (pozita aktuale: deputet) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: prona të paluajtshme, pasuri të luajtshme, para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, të hyra vjetore të tatueshme, dhe para të gatshme.<sup>24</sup> Në deklarin e pasurisë nga deputetja **Ramë Buja** (pozita aktuale: ministër) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: pasuri të luajtshme, para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, të hyra/paga vjetore të tatueshme, dhe detyrime financiare ndaj personave juridike dhe fizikë.<sup>25</sup>

Në deklarin e pasurisë nga deputetja **Safete Hadërgjonaj** (pozita aktuale: deputete) nuk është dhënë vlera e pasurive të patundshme (është shënuar 'vlera e tregut', në pronësi të familjes), kurse dallimet në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së janë në kategorinë e parave të gatshme të mbajtura në institucione financiare dhe të hyrave/pagave vjetore të tatueshme.<sup>26</sup> Në deklarin e pasurisë nga deputetja **Mimoza Ahmetaj** (pozita aktuale: deputete) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në kategorinë e pasurive të patundshme dhe bizneseve në pronësi.<sup>27</sup> Në deklarin e pasurisë nga deputeti **Nait Hasani** (pozita aktuale: deputet) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, para të tjera të gatshme, dhe të hyra/paga vjetore të tatueshme.<sup>28</sup> Ky deputet nuk i ka deklaruar AKK-së asnjë pasuri në pronësi të anëtarëve të tij të familjes.

### Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

Në deklarin e pasurisë nga deputeti **Sabri Hamiti** (pozita aktuale: deputet) nuk është specifikuar vlera e pasurive të paluajtshme, kurse dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së ka në këto kategori: para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, të hyra/paga vjetore të tatueshme. Ky deputet nuk ka deklaruar ndonjë pasuri tjetër të anëtarëve të familjes përveç njërit prej tyre.<sup>29</sup> Në deklarin e pasurisë nga deputeti **Eqrem Kryeziu** (pozita aktuale: deputet) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në kategorinë e pasurive të paluajtshme dhe atë të të hyrave/pagave vjetore të tatueshme.<sup>30</sup>

<sup>23</sup> Para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: €11,000 (AKK) asnjë (KQZ); të hyra/paga vjetore: €2,093 (AKK), €22,008 (KQZ); detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë: U.S. \$9,400 dhe €6,000 (AKK), asnjë (KQZ).

<sup>24</sup> Sa u përket patundshmërive, vlera e deklaruar AKK-së është €300,180 (personale) dhe €3,280,000 (familjare), kurse KQZ-së i ka deklaruar €430,000 (personale) dhe €1,100,000 (familjare); pasuri të luajtshme: €12,000 personale dhe €12,500 familjare (AKK), €16,500 (KQZ); para të gatshme të mbajtura në institucionet financiare: €20,500 (AKK), €8,300 (KQZ); sa u përket të hyrave vjetore të tatueshme, në deklarin për AKK-në ky deputet vetëm u është referuar atyre, pa specifikuar ndonjë shumë, kurse në deklarin për KQZ-në ka specifikuar shumën prej €18,000; para të gatshme: asnjë (AKK), €12,500 (KQZ) - €8,000 personale dhe €4,500 familjare.

<sup>25</sup> Pasuri të luajtshme: €15,000 (AKK), €17,000 – €11,000 personale dhe €6,000 familjare (KQZ); para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: €5,000 (AKK), asnjë (KQZ); të hyra/paga vjetore: €3,280 (AKK), €42,000 (KQZ); detyrime financiare ndaj personave juridike dhe fizikë: €31,300 (AKK), €1,000 (KQZ).

<sup>26</sup> Para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: €10,950 (AKK), €16,500 (KQZ); të hyra/paga vjetore: €15,528 dhe 'shtesat nga komisionet dhe seancat sipas pjesëmarrjes' (AKK), €15,528 (KQZ).

<sup>27</sup> Pasuri të paluajtshme: €166,000 (AKK), €116,000 (KQZ); bizneset në pronësi: asnjë (AKK), €50,000 (KQZ).

<sup>28</sup> Pasuria e paluajtshme: €1,100,000 (AKK), €1,550,700 (€700 personale dhe €1,550,000 e familjes (KQZ); pasuri të luajtshme: €10,000 (AKK), €20,000 (KQZ); para të gatshme të mbajtura në institucione financiare €3,000 – €5,000 (AKK), asnjë (KQZ); para të tjera të gatshme: asnjë (AKK), €7,000 (€4,000 personale dhe €3,000 familjare) (KQZ); të hyra/paga vjetore: asnjë (AKK), €14,700 (KQZ).

<sup>29</sup> Para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: €100,000 (AKK), €145,000 (KQZ); të hyra/paga vjetore: €3,338 në muaj – personale dhe €190 në muaj – e një anëtarë të familjes (AKK), €34,870.98 gjatë 12 muajve të fundit (KQZ).

<sup>30</sup> Pasuri të paluajtshme: €305,000 (AKK), €220,000 (KQZ); të hyra/paga vjetore: €25,640 – personale dhe €14,200 – e anëtarëve të familjes (AKK), €28,400 (KQZ).

Në deklarin e pasurisë nga deputeti **Ismet Beqiri** (pozita aktuale: deputet) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në kategorinë e parave të gatshme të mbajtura në institucione financiare dhe atë të të hyrave/pagave vjetore të tatueshme.<sup>31</sup> Në deklarin e pasurisë nga deputeti **Skender Hyseni** (pozita aktuale: deputet) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, të hyra/paga vjetore të tatueshme, dhe të ardhurat e përgjithshme vjetore nga pasuria dhe biznesi.<sup>32</sup> Në deklarin e pasurisë nga deputeti **Lutfi Haziri** (pozita aktuale: deputet) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, para të tjera të gatshme, të hyra/paga vjetore të tatueshme, dhe detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë.<sup>33</sup>

Në deklarin e pasurisë nga deputeti **Naser Osmani** (pozita aktuale: deputet) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, para të tjera të gatshme, dhe të hyra/paga vjetore të tatueshme. Ky deputet nuk ka deklaruar asnjë pasuri të anëtarëve të familjes.<sup>34</sup> Në deklarin e pasurisë nga deputeti **Lutfi Zharku** ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, para të tjera të gatshme, të hyra/paga vjetore të tatueshme, si dhe aksione në shoqëri komerciale dhe letra më vlerë. Ky deputet nuk ka deklaruar asnjë pasuri tjetër të anëtarëve të familjes.<sup>35</sup> Në deklarin e pasurisë nga deputeti **Armend Zemaj** (pozita aktuale: deputete) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, dhe të hyra/paga vjetore të tatueshme.<sup>36</sup> Ky deputet nuk ka deklaruar asnjë pasuri të anëtarëve të familjes.

### Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)

Në deklarin e pasurisë nga deputetja **Donika Kadaj-Bujupi** (pozita aktuale: deputete) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë, të hyra/paga vjetore të tatueshme, të ardhura të përgjithshme nga pasuria dhe biznesi, dhe para të gatshme të mbajtura në institucione financiare. As kjo deputete nuk ka

<sup>31</sup> Para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: €15,084 (AKK), asnjë (KQZ); të hyra/paga vjetore: €18,000 – personale dhe €6,000 – e anëtarëve të familjes (AKK), €17,000 (KQZ).

<sup>32</sup> Para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: €88,288 (AKK), €96,230.14 – personale dhe €9,900 – të anëtarëve të familjes (KQZ); të hyra/paga vjetore: €40,458.25 – personale dhe €14,900 – të anëtarëve të familjes (AKK), €38,483.58 (KQZ); të ardhurat e përgjithshme vjetore nga pasuria dhe biznesi: asnjë (AKK), €7,480 (KQZ).

<sup>33</sup> Pasuri të paluajtshme: €362,000 – pronë e përbashkët familjare (AKK), €500,000 – personale dhe €1,140,000 – pronë familjare (KQZ); pasuri të luajtshme: €25,000 (AKK), €20,000 – personale dhe €10,000 – familjare (KQZ); para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: €78,000 (AKK), €88,028 – personale, si dhe €37,80 dhe CHF65,800 – të anëtarëve të familjes (KQZ); para të tjera të gatshme: asnjë (AKK), €600 (KQZ); të hyra/paga vjetore: €23,730.35 (AKK), €18,000 (KQZ); detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë: asnjë (AKK), €50,000 (KQZ).

<sup>34</sup> Pasuri të paluajtshme: €40,000 (AKK), €47,000 (KQZ), pasuri të luajtshme: €15,000 (AKK), €32,000 (KQZ); para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: €10,000 (AKK), €12,000 (KQZ); para të tjera të gatshme: asnjë (AKK), €350 (KQZ); të hyra/paga vjetore: €18,000 (AKK), €19,300 (KQZ).

<sup>35</sup> Para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: €18,693.23 (AKK), €2,376 (KQZ); para të tjera të gatshme: asnjë (AKK), €5,000 (KQZ); të hyra/paga vjetore: €15,246 (AKK), €17,800 (KQZ); aksione në shoqëri komerciale dhe letra me vlerë: €8,655 (AKK), €10,000 (KQZ).

<sup>36</sup> Pasuri të paluajtshme: €350,000 (AKK), €200,000 (KQZ); pasuri të luajtshme: €7,500 (AKK), asnjë (KQZ); para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: €16,500 (AKK), €40,000 (KQZ); të hyra/paga vjetore: €1,988 (AKK), €20,000 (KQZ).



deklaruar asnjë pasuri të anëtarëve të familjes.<sup>37</sup> Në deklarimin e pasurisë nga deputeti **Ardian Gjini** (pozita aktuale: deputet) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, të hyra/paga vjetore të tatueshme, para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, si dhe detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë.<sup>38</sup> As ky deputet nuk ka deklaruar asnjë pasuri të anëtarëve të familjes. Në deklarimin e pasurisë nga deputeti **Ahmet Isufi** (pozita aktuale: deputet) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, para të gatshme të tjera, të hyra/paga vjetore të tatueshme, si dhe detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë. Ky deputet nuk ka deklaruar asnjë pasuri në pronësi të anëtarëve të tij të familjes.<sup>39</sup>

### Aleanca Kosova e Re (AKR)

Në deklarimin e pasurisë nga deputetja **Myzejene Selmani** (pozita aktuale: deputete) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së vetëm në kategorinë e pasurive të paluajtshme dhe në atë të detyrimeve ndaj personave juridikë dhe fizikë.<sup>40</sup> Në deklarimin e pasurisë nga deputeti **Ibrahim Makolli** (pozita aktuale: ministër) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: pasuri të paluajtshme, para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, dhe të hyra/paga vjetore të tatueshme. Ky deputet nuk ka deklaruar ndonjë pasuri të anëtarëve të familjes.<sup>41</sup> Në deklarimin e pasurisë nga deputeti **Ibrahim Gashi** (pozita aktuale: zëvendësministër) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në këto kategori: pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, para të gatshme të mbajtura në institucione financiare, të hyra/paga vjetore të tatueshme, dhe detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë.<sup>42</sup> Në deklarimin e pasurisë nga deputetja **Suzan Novobrdaliu** (pozita aktuale: deputete) ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së ka dallime në mes të vlerës monetare të pasurisë që i është deklaruar AKK-së dhe KQZ-së në kategorinë e parave të gatshme të mbajtura në institucione financiare dhe atë të të hyrave/pagave vjetore të tatueshme.<sup>43</sup>

<sup>37</sup> Sa u përket pasurive të paluajtshme, kjo deputete nuk ka specifikuar vlerën e saj në deklarimin e KQZ-së, kurse në atë të AKK-së shuma e specifikuar është €300,000; pasuri të luajtshme: €1,000 (AKK), asnjë (KQZ); detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë: €50,000 dhe €806 në muaj (AKK), €70,000 (KQZ); të hyra/paga vjetore: nuk është specifikuar (AKK), €21,000 (KQZ); të ardhura të përgjithshme nga pasuria dhe biznesi: €30,000 (AKK), asnjë (KQZ); para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: asnjë (AKK), €500 (KQZ).

<sup>38</sup> Pasuri të paluajtshme: €350,000 (AKK), €345,000 (KQZ); pasuri të luajtshme: €15,000 (AKK), €10,000 (KQZ); të hyra/paga vjetore: €1,298 në muaj dhe 'deri në €6,000 në vit' (AKK), €19,000 (KQZ); para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: asnjë (AKK), 1,000 (KQZ); detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë: asnjë (AKK), €100,000 (KQZ).

<sup>39</sup> Pasuri të paluajtshme: €356,000 (AKK), €414,000 (KQZ); pasuri të luajtshme: asnjë (AKK), €13,000 (KQZ); para të gatshme të mbajtura në institucionet financiare: €350 (AKK), €680 (KQZ); para të gatshme të tjera: asnjë (AKK), €200 (KQZ); të hyra/paga vjetore: €18,000 (AKK), €21.600 (KQZ); detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë: asnjë (AKK), €35,000 (KQZ).

<sup>40</sup> Pasuri të luajtshme: asnjë (AKK), €3,000 (KQZ); detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë: asnjë (AKK), €200 (KQZ).

<sup>41</sup> Pasuri të paluajtshme: €160,000 (AKK), vlera nuk është specifikuar (KQZ); para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: €1,220 (AKK), €1,200 (KQZ); të hyra/paga vjetore: €1,700 (AKK), gjithsej €14,400 (KQZ).

<sup>42</sup> Pasuri të paluajtshme: €425,000 (AKK), €230,000 (KQZ); pasuri të luajtshme: €3,500 – e njërit anëtar të familjes (AKK), asnjë (KQZ); para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: asnjë (AKK), €1,500 (KQZ); të hyra/paga vjetore: gjithsej €33,240 (AKK), €19,800 (KQZ); detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë: €35,000 (AKK), asnjë (KQZ).

<sup>43</sup> Para të gatshme të mbajtura në institucione financiare: €8,967 (AKK), €15,000 (KQZ); të hyra/paga vjetore: €30,177.98 (AKK), €24,520 (KQZ).

## Analizë Politikash

**Tabela 1: Përmbledhje e gjetjeve – diferenca në vlerën e pasurisë së deklaruar AKK-së dhe KQZ-së nga 27 zyrtarët e lartë të zgjedhur drejtpërdrejt të përzgjedhur për këtë studim politikash**

Nr.	Emri	Subjekti politik	Vlera e përgjithshme e deklaruar		Diferenca
			AKK	KQZ	
1	Jakup Krasniqi	PDK	300,000	32,400	
			600,000	8,100	
			32,400	30,000	
			15,000	85,000	
			85,000	21,000	
			11,500	300,000	
			10,780	60,000	
			7,200	11,500	
			<b>€1,061,880</b>	<b>€548,000</b>	
2	Fatmir Limaj	PDK	80,000	8,928	
			70,000	7,635	
			250,000	47	
			500,000	4,341	
			20,000	225	
			25,000	80,000	
			225	70,000	
			26,029	250,000	
			1,270	500,000	
			744	20,000	
			40,000	25,000	
	40,000				
<b>€1,013,268</b>	<b>€1,006,176</b>	<b>€7,092</b>			
3	Vlora Çitaku	PDK	85,000	17,736	
			57,000	6,060	
			6,000	10,324	
			10,324	85,000	
			1,478	57,000	
			505	6,000	
			<b>€160,307</b>	<b>€182,120</b>	
4	Hajredin Kuçi	PDK	200,000	15,000	
			200,000	6,000	
			10,000	12,000	
			16,000	6,000	
			14,196	15,000	
			7,200	200,000	
			6,000	200,000	
			39,900	10,000	
			10,000	15,000	
			5,040		
<b>€468,476</b>	<b>€479,000</b>	<b>€10,524</b>			
5	Enver Hoxhaj	PDK	65,000	15,240	
			30,000	17,856	
			95,000	4,556	
			40,000	37,000	
			37,825	65,000	
			15,240	95,000	
			17,856	30,000	
			5,556	40,000	
			95,000		
			40,000		
			10,000		
5,400					
<b>€456,877</b>	<b>€286,796</b>	<b>€170,081</b>			
6	Xhavit Haliti	PDK	120,000	27,863	

## Analizë Politikash

			7,000 120,000 23,863	20,000 1,110 120,000 85,000 6,250 500,000 250,000 250,000 120,000 7,000 15,000 32,000	
			<b>€270,863</b>	<b>€1,434,223</b>	<b>€1,163,360</b>
7	Edita Tahiri	PDK	300,000 200,000 5,000 16,000 11,000 1,293 800 6,000 \$9,400 <b>€540,093</b> <b>\$9,400</b>	22,008 300,000 200,000 5,000 16,000	<b>€2,915</b> <b>\$9,400</b>
8	Adem Grabovci	PDK	180,000 150,000 500,000 600,000 600,000 150,000 50,000 12,000 3,000 14,000 4,500 <b>€2,263,500</b>	18,000 1,100,000 200,000 230,000 4,500 5,000 4,000 4,500 3,000 800 12,500 6,000 <b>€1,588,300</b>	<b>€675,200</b>
9	Ramë Buja	PDK	150,000 50,000 50,000 15,000 5,000 1,480 1,200 600 31,300 29,000 651 <b>€334,231</b>	24,000 18,000 130,000 100,000 21,000 3,000 3,000 1,000	<b>€34,231</b>
10	Safete Hadërgjonaj	PDK	8,950 2,000 15,528 <b>€26,478</b>	15,528 14,500 2,000 <b>€32,028</b>	<b>€5,550</b>
11	Mimoza Ahmetaj	PDK	100,000 16,000 50,000 16,000 30,000	14,400 36,000 7,000 50,000 100,000	

## Analizë Politikash

			14,400 36,000 <b>€262,400</b>	16,000 30,000 16,000 <b>€269,400</b>	<b>€7,000</b>
12	Nait Hasani	PDK	500,000 300,000 250,000 50,000 10,000 5,000 <b>€1,115,000</b>	14,700 4,000 2,000 1,000 300,000 250,000 700 1,000,000 20,000 <b>€1,592,400</b>	<b>€477,400</b>
13	Sabri Hamiti	LDK	200,000 1,970 100,000 28,800 5,856 5,400 2,280 <b>€344,306</b>	23,670 5,400 5,800 100,000 45,000 200,000 <b>€379,870</b>	<b>€35,564</b>
14	Eqrem Kryeziu	LDK	25,000 30,000 250,000 23,000 2,400 240 35,000 2,800 4,200 7,200 <b>€379,840</b>	26,000 2,400 150,000 50,000 20,000 35,000 <b>€283,400</b>	<b>€96,440</b>
15	Ismet Beqiri	LDK	232,000 4,008 11,076 18,000 6,000 <b>€271,084</b>	17,000 230,000 <b>€247,000</b>	<b>€24,084</b>
16	Skender Hyseni	LDK	350,000 118,000 40,000 6,000 83,098 5,190 19,801 14,456 6,200 3,600 5,000 6,300 <b>€657,645</b>	13,301 19,281 7,480 5,900 3,600 6,300 96,148 82 350,000 118,000 40,000 6,000 <b>€666,092</b>	<b>€8,447</b>
17	Lutfi Haziri	LDK	350,000 12,000 25,000 73,000 5,000	18,000 48,000 2,880 600 88,028	

## Analizë Politikash

			23,730 12,000 10,000	9,000 7,000 500,000 350,000 500,000 290,000 10,000 20,000 50,000 CHF 10,800	
			<b>€510,730</b>	<b>€1,893,508</b> <b>CHF 10,800</b>	<b>€1,382,778</b> <b>CHF10,800</b>
18	Naser Osmani	LDK	40,000 15,000 10,000 18,000	12,100 7,200 350 12,000 47,000 32,000	<b>€27,650</b>
			<b>€83,000</b>	<b>€110,650</b>	
19	Lutfi Zharku	LDK	150,000 170,200 16,017 1,427 1,141 106 15,246 8,655	17,800 5,000 501 1,875 10,000 150,000 170,200	<b>€7,416</b>
			<b>€362,792</b>	<b>€355,376</b>	
20	Armend Zemaj	LDK	200,000 150,000 7,500 16,500 1,488 500	20,000 200,000 40,000 40,000	<b>€75,988</b>
			<b>€375,988</b>	<b>€300,000</b>	
21	Donika Kadaj-Bujupi	AAK	250,000 50,000 50,000 1,000 30,000 9,672	12,000 500 70,000	<b>€308,172</b>
			<b>€390,672</b>	<b>€82,500</b>	
22	Ardian Gjini	AAK	250,000 200,000 15,000 15,576 6,000	19,000 1,000 130,000 15,000 200,000 10,000 70,000 10,000 20,000	<b>€11,576</b>
			<b>€486,576</b>	<b>€475,000</b>	
23	Ahmet Isufi	AAK	75,000 186,000 80,000 15,000 350	21,600 200 120 74,000 160,000	



## Analizë Politikash

			18,000	180,000 13,000 35,000	
			<b>€374,350</b>	<b>€483,920</b>	<b>€109,570</b>
24	Myzejene Selmani	AKR	300,000 2,500 1,871	1,780 53,400 300,000 3,000 2,500 2,500 200	<b>€59,009</b>
			<b>€304,371</b>	<b>€363,380</b>	
25	Ibrahim Makolli	AKR	60,000 100,000 5,000 1,100 120 1,700 15,000	14,400 1,200 5,000 15,000	<b>€147,320</b>
			<b>€182,920</b>	<b>€35,600</b>	
26	Ibrahim Gashi	AKR	200,000 150,000 75,000 25,000 22,800 5,640 4,800 15,000 10,000 10,000 3,500	15,000 4,800 150,000 25,000 80,000 1,500	<b>€245,440</b>
			<b>€521,740</b>	<b>€276,300</b>	
27	Suzan Novobrdaliu	AKR	200,000 3,576 3,800 17,177 13,100	21,520 3,000 6,000 3,000 6,000 200,000	<b>€1,867</b>
			<b>€237,653</b>	<b>€239,520</b>	

### Konkluzione me rekomandime

Gjetjet e paraqitura në këtë analizë politikash tregojnë se deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë publik ende përballet me sfida dhe probleme. Ndër më kryesoret të identifikuara këtu, përfshirë rekomandimet për adresimin e tyre, paraqiten në vijim.

Së pari, ka dallime të konsiderueshme në mes të formularit të AKK-së dhe atij të KQZ-së për deklarimin e pasurive të zyrtarëve të lartë të zgjedhur. Prandaj ka nevojë që të dy formularët të harmonizohen sa i përket përmbajtjes, në mënyrë që të reflektojnë të gjitha llojet e pasurive, në mënyrë që të lehtësohet plotësimi i tyre nga respondentët, si dhe kontrolli dhe monitorimi më i lehtë dhe më lehtë i qasshëm për nga përmbajtja, si nga institucionet përgjegjëse, ashtu edhe nga publiku i gjerë.

Së dyti, marrë parasysh ngatërrimet e shpeshta në plotësimin e formularit nga zyrtarët e lartë publikë, për shkak të niveleve dhe kohëzgjatjes së ndryshme të përvojës, duket se më praktike do të ishte hartimi i formularëve të veçantë për secilin lloj të deklarimit të pasurisë të paraparë me Nenin 5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë, pasi që edhe kjo do ta lehtësonte dhe rriste precizitetin e informatave të dhëna.

Më tej, marrë parasysh paqartësitë e shumta të vërejtura në kategorizimin e pasurisë, përcaktimin e vlerës së saj në bazë të çmimit të tregut dhe raportimit të saj në shifra monetare, gjithashtu kërkohet që të dilet me një udhëzues politikash për deklarimin e pasurisë. Ky lloj udhëzuesi do të duhej të përkufizonte dhe precizonte kuptimin e secilës kategori të pasurive dhe termave të tjerë që përdoren, bazuar në mënyrën se si gjejnë zbatim ato terma në bazë të kornizës ligjore në fuqi në Kosovë, e në veçanti të vendoste qartazi linjat ndarëse në mes të kategorive të ndryshme të pasurive. I njëjti do të duhej gjithashtu të jepte udhëzime adekuate për kategorizimin e prejardhjes së pasurisë, kalkulimin e vlerës së saj bazuar në çmimet e tregut, dhe shprehjen e saj në vlera monetare.

Një pikë tjetër ku vërehen mangësi ka të bëjë me prejardhjen e pasurisë. Prandaj kërkohet që përveç kategorizimit preciz të prejardhjes gjithashtu të vendosen procedura dhe mekanizma të qartë dhe të efektshëm për verifikimin e të dhënave të ofruara nga vetë deklaruesit e pasurive.

Adresimi i këtyre dhe mangësive të tjera në sigurimin e të dhënave sa më të plota dhe të qarta mbi të gjitha kategoritë e pasurive gjithashtu kërkon monitorim më sistematik gjatë mbledhjes së informatave. Ndonëse në këtë do të ndihmonte udhëzuesi i politikave i rekomanduar më sipër, zyrtarët monitorues gjithashtu duhet të jenë në dispozicion për t'u ofruar deklaruesve sqarime dhe udhëzime në kohë të duhur.

Së fundi, por jo më pak me rëndësi, pasi që është vërejtur se shpesh ka mospërputhje të dhënash për kategori të ndryshme të pasurisë, dhe madje shpesh edhe të dhëna kundërthënëse, gjithashtu nevojitet të ekzistojnë procedura dhe mekanizma të efektshëm për të adresuar këto lloj mospërputhjesh dhe të dhënash kundërthënëse.

### Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga National Endowment for Democracy (NED). Ky Raport është produkt dhe rezultat i një ekipi të përkushtuar të FOL-it dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë webfaqe: [www.levizjafol.org](http://www.levizjafol.org)

### Rreth Lëvizjes FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.